



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:220092
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05567738

C-III-24-0025

Paditësja

F M, te cilën e përfaqëson e bija M H, Gjakovë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit-AKP, Rr. “Dritan Hoxha ”nr.55, Lakërishtë ,Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), Kolegji i përbërë nga Diellza Hoxha gjyqtare kryesuese, Gazmend Sylaj dhe Hajrie Shala gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 prill 2024 merr këtë:

AKTVENDIM

- 1. Propozimi i paditëses për caktimin e Masës se Sigurimit refuzohet si i pabazuar .**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore .**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 17 tetor 2023, paditësja ka parashtruar padi ne Gjykatën Themelore ne Gjakove kundër te paditurës AKP-se me propozim për caktimin e masës se përkohshme për ngastrën kadastrale ZK Gjakove që është pronë e NSH “Ereniku”.

Gjykata Themelore ne Gjakove me Aktvendimin e saj C.nr.1709/23 të datës 18.10.2023 shpalli veten in kompetente dhe lëndën e dërgoi në DHPGJS për procedim te mëtutjeshëm .

Paditësja në padi thekson se është bashkëpronare e 1/7 pjese ideale të ngastrës .. e cila është në fqinjësi me ngastrën ... pronë e NSH “Ereniku”. Qysh nga viti 2007 ka ushtruar padi për vërtetimin e pronësisë kundër familjes Kameri për ngastrën kadastrale .. por kjo padi deri me tani nuk ka marr epilog gjyqësor. Të drejtën subjektive e vërteton përmes ekspertizave të datës 14.04.2009 për lëndën Cnr.225/07 dhe të datës 26.05.2021 për lëndën C-III-15-0317 në të cilat konstatohet kufiri ndarës me pronën e të paditurës , një pjesë shfrytëzohet nga paditësja pjesa tjetër fqinje nga e paditura AKP-ja .

Nga ekspertizat shihet në mënyrë grafike se shfrytëzuese në token fqinje të ngastrës kontestuese është paditësja se bashku me familjaret e saj ku e kanë të ndërtuar shtëpinë . Pasi që ka konflikte të vazhdueshme verbale midis familjeve rreth shfrytëzimit të pronës kontestuese tani ushtron padi për vërtetimin e parablerjes për ngastrën ...-0 e cila është në pronësi të NSH “Ereniku”. Padinë e bazon në nenin 516 të LMD –se i cili përcakton se *persona te caktuar mund te kenë te drejtën e parablerje sipas ligjit , dhe se kohëzgjatja e drejtës se parablerjes eshte e pa kufizuar* . Si shfrytëzuese e pronës kontestuese konsideron se i takon kjo e drejte, andaj nga gjykata kërkon aprovimin e kërkesëpadsisë dhe vërtetimin e drejtës se parablerjes se ngastrës ...-0 ZK Gjakove prone e NSH “Ereniku” .

Kërkesa për caktimin e Masës së Sigurimit

Për shkak të konflikteve verbale të vazhdueshme mes familjeve që janë ende në kontest pa epilog gjyqësorë dhe se e ekziston rreziku që e paditura AKP-ja mund ndërmarr veprime të tjetërsimit të pronës dhe të shkaktohet dëm i riparueshëm paditëses i propozon gjykatës që të caktohet masa e sigurimit, ti ndalohej të paditurës AKP-së të tjetërsoj , fshehtë , ngarkojë disponojë apo të ndërmarr çfarëdo veprimi tjetër i cili do të shkaktohte dëm të riparueshëm

Padisë si prove ka bashkangjitur :

- Kopjen e padisë të parashtruar në Gjykatën Komunale në Gjakove të datës 19.03.2007
- Kopjen e ekspertizës për këtë lëndën .Cnr.225/07 të datës 14.04.2009
- Kopjen e ekspertizës për lëndën C-III-15-0317 të datës 26.05.2021
- Autorizimin e vërtetuar të noteri për vajzën e saj M H e lindur M

AKP me 28 shkurt 2024 e paditura AKP parashtrori përgjigje në kërkesën për masë të sigurimit, në të cilën i kundërshton të gjitha pretendimet e paditëses të paraqitura në padinë e saj duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. Po ashtu e paditura pohoi se konsideron se paditësja në asnjë rrethanë nuk kanë paraqitur argumente ligjore se për cilat arsye gjykata duhet caktuar masë të sigurimit në kërkesën e saj . AKP-ja me anë të përgjigjes së saj konsideron se propozimi nuk i plotëson kriteret ligjore, të parapara sipas nenin 61.1 të ligjit nr. 06/L-086 për DHPGJS. AKP-ja propozon që kërkesa për MS të refuzohet .

Arsyetimi ligjor:

Në pajtim të nenit 61.1 të Ligjit të DHPGJS mund të nxjerrë Masë të Sigurimit me kusht që parashtruesi të jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet një MS. Sipas nenit 61.1, dëmi konsiderohet si i ‘pariparueshëm’ vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Për më tepër padia do të konsiderohej si e bazuar.

Andaj pala duhet të ofrojë prova të besueshme se do të rezultojë me dëmtim të *menjëhershëm* dhe të *pariparueshëm financiarisht* nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet. Barra e provave bien mbi paditësit.

Pa paragjykim të vendosjes së plotë lidhur mbi padinë, gjykata konstaton se në këtë rast, paditësja nuk ka ofruar dëshmi të besueshme, që do të arsyetonte lëshimin MS. Paditësja nuk kanë parashtruar asnjë dëshmi mbi ekzistimin e rrezikut të dëmit dhe për më tepër të parashtrorë asnjë dëshmi e që do të argumentonte që dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm do të shkaktohej në qoftë se Masa e Sigurimit nuk do të lëshohej.

Për më tepër gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dokumenteve të parashtruara nga paditësja e cila kishte cekur se ka kontest të papërfunduar në gjykate për këtë ngastër ka gjetur se në lenden C-III-15-0317 për të cilën ka parashtruar edhe ekspertizën është refuzuar kërkesa për caktimin e masës së sigurimit dhe po ashtu është refuzuar ankesa e paditëses ushtruar kundër vendimit të AL për kërkesën për vërtetim të drejtës se pronësisë për ngastrën ...-0 ZK Gjakove .

Andaj, kërkesa për lëshimin e Masës së Sigurimit nuk i plotëson kriteret ligjore ashtu siç parashihen sipas nenit 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme .

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet

Paditësja ka paguar taksën gjyqësore me parashtrim të padisë dhe propozimit për masë të sigurisë në Gjykatën themelore në Gjakovë .

Këshilla ligjore

Në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS, apeli kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJS në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Diellza Hoxha, Gjyqtare kryesuese

Gazmend Sylaj, Gjyqtar

Hajrie Shala, Gjyqtare
